



AMF

Objektivat
dhe programi
afatmesëm

Shtator 2007

AMF

**Objektivat
dhe programi afatmesëm**

Shtator 2007

PËRMBLEDHJE	3
I. MBIKËQYRJE EFIKASE ME BAZË RISKU	4
II. FAKTORË TË JASHTËM QË NDIKOJNË NË TREG	4
1. TENDENCA NDËRKOMBËTARE	4
A. MARRËVESHJA E ASOCIM STABILIZIMIT ME BE	4
B. IMPLEMENTIMI I IFRS-VE NË 2008	5
C. HYRJA NË TREG E INVESTITORËVE TË HUAJ	6
2. TENDENCA VENDASE	6
A. NJË SHIKIM MBI TREGUN E SIGURIMEVE DHE MBIKËQYRJES AKTUALE	6
B. NJË SHIKIM I TREGUT TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE PRIVATE	8
C. NJË SHIKIM MBI TREGUN E LETRAVE ME VLERË	9
III. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE	10
1. PAVARËSIA	10
2. STAFI-BURIMET NJERËZORE	10
3. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT NË AMF	12
IV. NDRYSHIME OPERACIONALE STRATEGJIKE	13
1. KUADRI LIGJOR	13
2. MBIKËQYRJA ME BAZË RISKU	14
3. LICENCIMI	15
4. MBROJTJA E KONSUMATORIT	16
5. DËMET	16
6. REFORMA INSTITUCIONALE E BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMEVE 17	
7. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	18
8. RISIGURIME	19
9. PRODUKTE TË REJA TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM	19
10. PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË VRULLSHËM TË SEKTORIT JO-BANKAR	22

Përmbledhje

Autoriteti i Mbikëqyjes Financiare është themeluar gjatë vitit 2006. Autoriteti konsolidoi funksionet rregulluese-mbikëqyrëse të aktiviteteve financiare jo-bankare të kryera më parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Inspektoriati i Insituteve të Pensioneve Suplementare Private. Objektivat e Autoritetit janë mbrojtja e interesave të konsumatorëve, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiarë jo-bankarë dhe sigurimi i respektimit të ligjit.

Tregu i sigurimeve zë peshën kryesore në tregjet financiare jo-bankare, ndërsa tregjet e letrave me vlerë dhe të pensioneve private janë në hapat fillestare të zhvillimit. Tregu shqiptar i sigurimeve, megjithë sfidat dhe problemet, së fundmi ka qenë subjekt i një tendence pozitive zhvillimi dhe paraqet një potencial të madh për zgjerim cilësor dhe sasior. Ky potencial bazohet në kushtet e favorshme ekonomike, sistemin e përmirësuar të rregullim-mbikëqyrjes, shkallën e ulët të penetrimit të tregut si dhe në një komunitet biznesi dhe popullsi dinamike e lehtësisht të adaptueshme. Është e rëndësishme të theksojmë që tregu është mjaft atraktiv për investitorët e huaj.

Ndër prioritetet kryesore të Autoritetit në të ardhmen janë përmirësimi i kuadrit rregullator duke siguruar një përafrim me direktivat e Komunitetit Evropian, për tre sektorët financiarë nën juridiksion, kalimi në një sistem mbikëqyrje me bazë risku e shoqëruar me futjen në përdorim të platformave të zhvilluara të IT-së, si dhe promovimi i zhvillimit të tregjeve dhe produkteve të ofruara në këto tregje.

Misioni

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e të gjitha rregullave.

Vizioni

Ne synojmë nëpërmjet ngritjes së vazhdueshme të nivelit të

rregullimit dhe mbikëqyrjes në treg, promovimin dhe nxitjen e standarteve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integritetin e të licencuarve, rritjen e efikasitetit dhe stabilitetit të tregut financiar jo-bankar si dhe përmirësimin e shkallës së profesionalizmit.

I. Mbikëqyrje efikase me bazë risku

AMF po punon drejt implementimit të Mbikëqyrjes me bazë risku në mënyrë që të sigurojë stabilitet financiar në treg dhe zhvillim të sigurtë të tregut.

AMF ka formuluar një strategji zhvillimi në mënyrë që të parashtrojë objektivat e tij për periudhën e afërt afat mesme. Këto objektiva konsistojnë në sigurimin e vazhdimësisë së operimit transparent dhe efikas të tregjeve financiare, forcimin e besueshmërisë në tregjet financiare, promovimin e zhvillimit të tyre bazuar në konkurrencë të drejtë, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe minimizimin e risqeve të mbartur prej tyre me anë të dhënies se informacinit të saktë mbi tregun.

AMF në bashkëpunim me Bankën Botërore do të arrijë objektivat e parashtruar nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe implementimit të ndryshimeve operacionale strategjike.

AMF do të implementojë modelet e mëposhtme në mënyrë që të arrijë objektivat dhe ndryshimet e parashtruara.

II. Faktorë të jashtëm që ndikojnë në treg

1. Tendenca ndërkombëtare

A. Marrëveshja e Asocim Stabilizimit me BE

Krijimi i AMF gjatë vitit 2006 si një ent mbikëqyrës i pavarur për sektorin financiar jo-bankar reflekton angazhimin politik të

qeverisë Shqiptare për të përvetësuar standartet rregullatore dhe mbikëqyrëse europiane. Kjo do të përfshijë krijimin e drafteve plotësuese të legjislacionit për sektorin e sigurimeve, të pensioneve private suplementare dhe tregut të letrave me vlerë.

AMF në bashkëpunim me Bankën Qëndrore të Shqipërisë, Ministrinë e Integritimit dhe të tjerë ente financiare do të krijojë grupe pune të cilët do të punojnë për përpilimin e drafteve dhe propozimin e rregulloreve dhe modeleve të reja sipas direktivave të BE në përputhje me marrëveshjen e Asocim Stabilizimit firmosur në 2006.

Një prej prioriteteve afatshkurtra për AMF-në mbetet përforsimi i kuadrit ligjor dhe roli mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve.

Në nenin 70 të marrëveshjes së Asocim Stabilizimit përfshihet obligimi për aderim në Legjislacionin e BE. Në nenin 50, qeveria Shqiptare angazhohet të trajtojë në mënyrë të barabartë dhe të ofrojë mundësi të barabarta me kompanitë Shqiptare edhe atyre Europiane.

B. Implementimi i IFRS-ve në 2008

Përshtatja e legjislacionit në përputhje me nevojat e zhvillimit dhe harmonizimin me direktivat e BE përbën një nga prioritetet bazë të institucionit lidhur me rregullimin e tregut sipas standarteve ndërkombëtare. Rritja e fondit të garancisë, e aprovuar tashmë nga parlamenti, dhe hyrja e IFRS në 2008 do të pasohet nga sipërmarrje të tjera të AMF si përmirësimi i legjislacionit në përputhje me direktivat e BE-së. Targeti i përmirësimit të kuadrit ligjor do të jetë krijimi i një ambjenti më të sigurt për operatorët me aktivitet nëpër tregje të mbikëqyrura. Nga ana tjetër, AMF do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha strukturat e tjera me qëllim miratimin e legjislacionit në përputhje me zhvillimin dhe kërkesat e tregut, si dhe sigurimin e zbatimit të këtij legjislacioni.

AMF në bashkëpunim me Shoqërinë Austriake të siguruesve si dhe kompaninë audituese KPMG Albania, organizoi më 16-18 Korrik 2007 një workshop rreth standarteve ndërkombëtare mbi raportimin financiar (IFRS) në sektorin e sigurimeve. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues nga shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri dhe nga AMF.

C. Hyrja në treg e investitorëve të huaj

Zhvillimi makroekonomik i vendit së bashku me zhvillimin e shpejtë të sektorit bankar mundësojnë rritje të qëndrueshme të tregjeve financiare jo-bankare. Këta faktorë, të shoqëruar me përmirësimin e mbikëqyrjes të tregjeve financiare, kanë tërhequr interesin e shoqërive ndërkombëtare të sigurimit dhe shoqërive të pensioneve private suplementare. Vlen të përmendim që disa nga shoqëritë Europiane të sigurimit kanë nisur bashkëpunimin me disa nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar. Shoqëritë ndërkombëtare kanë treguar mjaft interes në procesin e privatizimit të Insig sh.a, proces ky që pritet të përfundojë brenda vitit 2007.

Më 25 Prrill 2007, Bordi i AMF ka miratuar shitjen e 51% të aksioneve të Interlbanian sh.a shoqërisë “Aspis Holdings Public Company Ltd” me qendër në Qipro. Më 30 Gusht 2007 Bordi i AMF ka miratuar shitjen e 75% +1 të aksioneve të Sigma sh.a shoqërisë “TBIH Financial Services Group” N.V me qendër në Amsterdam, Hollandë.

Investitori UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH, Austria ka blerë opsionin put nga Sigal Holding.

2. Tendanca vendase

A. Një shikim mbi tregun e sigurimeve dhe mbikëqyrjes aktuale

Tregu financiar jo-bankar në Shqipëri përbehet nga 11 shoqëri sigurimesh, 3 pensione private suplementare, 6 brokera (banka)

që operojnë në tregun sekondar të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë. Kur flitet për qarkullimin dhe kompleksitetin e tregut, mbikëqyrja e sektorit të sigurimeve është jetik. Tregu i sigurimeve dominohet nga sigurimet motorrike të detyruara të cilat zënë përafërsisht dy të tretat e totalit të primeve. Pensionet private dhe tregu i letrave me vlerë janë nën zhvillim dhe nga AMF pritet ta ketë këtë zhvillim nën fokus.

Meqënëse tregu i sigurimeve dominon sektorin jo-bankar, një prej prioriteteve të AMF është arritja e një mbikëqyrjeje efektive të shoqërive të sigurimit. Përveç zhvillimit dhe përfortimit të kapacitetit dhe mjeteve të mbikëqyrjes aktuale, AMF po përpiqet të permiresojë procesin e raportimit nga pjesëmarrësit e tregut, si dhe procesin e analizimit të këtij informacioni. Pjesa dërmuse e raportimit aktual është paper-based duke shkaktuar kështu vonesa në analizën e gjendjes financiare të shoqërive dhe të analizës së përgjithshme të tregut.

Kjo gjithashtu rezulton edhe në kohën e nevojshme për marrjen e hapave korrektuese nga AMF. AMF po mundohet të prezantojë programe IT për sisteme raportimi online për të dhënat financiare, dëme, prime, etj. Instalimi i një programi të tillë do t'i mundësojë AMF-së të marrë raportet online, të zhvillojë analiza në mënyrë të shpejtë dhe konsistente si dhe t'i japi prioritet rasteve që e kërkojnë.

Më tetor 2007, AMF ka miratuar një rregullore “Për Rregjistrin Elektronik Online të shitjeve të policave të sigurimit motorrik të detyrueshëm”.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Policat e sigurimit të detyrueshëm motorrik që janë subjekt identifikimi dhe raportimi sipas kësaj rregulloreje janë policat për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve

motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, policat e kartonit jeshil dhe policat e sigurimit kufitar.

B. Një shikim i tregut të pensioneve suplementare private

Sistemi i pensioneve në Shqipëri është në një nivel të ulët zhvillimi në krahasim me vendet e rajonit. Ky sistem është kryesisht i bazuar në shtyllën e financuar nga shteti, ose siç quhet ndryshe Skema e Sigurimeve Shoqërore (sistemi PAYG, ose pay-as-you-go).

Ekzistenca e kolonës së tretë të pensioneve në Shqipëri është ende në fillimet e saj. Pavarësisht miratimit të ligjit “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve” që në vitin 1995, aktiviteti i shoqërive të para private në fushën e pensioneve filloi në vitin 2006.

Gjatë kësaj periudhe, këto shoqëri i kanë kushtuar kujdes marketingut për të tërhequr sa më shumë kontribues. Pavarësisht këtij fakti, konsumatorët nuk janë ende të familjarizuar me përfitimet që ofrojnë këto produkte.

Nisur nga rëndësia që ka kolona e tretë në sistemit e pensioneve si dhe bazuar në kufizimet që ka kuadri ligjor ekzistues për organizimin e kësaj kolone, arrihet në përfundimin se zhvillimi i saj kërkon ndryshime rrënjësore të cilat duhet të përputhen me direktivat europiane.

AMF duhet të fokusohet kryesisht në këto drejtime:

- Stimulimi dhe përfshirja në këto skema e punëdhënësve dhe individëve nëpërmjet krijimit të politikave nxitëse ligjore e fiskale;
- Rritja dhe forcimi i elementëve të mirëadministrimit të instituteve të pensioneve private;

- Nxitja dhe zhvillim i tregut të kapitaleve në vend, pasi është i lidhur ngushtë me zhvillimin e tregut të pensioneve.

Ndërmarrja e masave për plotësimin e kushteve të sipërpërmendura do të sjellë domosdoshmërisht rezultate pozitive në tregun shqiptar të pensioneve private suplementare.

C. Një shikim mbi tregun e letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga tregtimi në tregun primar dhe atë sekondar të instrumenteve të borxhit të Qeverisë, ndërsa tregu i letrave me vlerë të aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar dhe i kufizuar kryesisht në tregun informal të aksioneve të kompanive të regjistruara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Vitet e fundit vihet re një rritje e konsiderueshme e interesit të subjekteve të ndryshme vendase dhe të huaja për t'u licencuar dhe ushtruar aktivitet në tregun vendas të letrave me vlerë.

Aktiviteti mbikëqyrës i Autoritetit në fushën e letrave me vlerë është fokusuar kryesisht në ndjekjen e vazhdueshme të zhvillimit të treguesve të tregut. Gjithashtu, për të pasur një vlerësim sa më real të këtyre treguesve, AMF i ka dhënë prioritet standardizimit të procesit të raportimit periodik që duhet të bëjnë operatorët mbi statistikat e ecurisë së tregut të letrave me vlerë.

Tregu i kapitaleve mbetet ende pjesa më e pazhvilluar e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri. Ky treg përbëhet nga tregu zyrtar (Bursa e Tiranës), tregtarët e licencuar për të tregtuar në letra me vlerë dhe tregu informal i transaksioneve mbi aksionet e shoqërive aksionere.

Bursa e Tiranës (BT), e krijuar që në vitin 1996, është shoqëri anonime shtetërore me pronar të vetëm Ministrin e Financave, e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë (sot AMF) si treg i

organizuar i letrave me vlerë të borxhit dhe aksioneve. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, ky institucion nuk ka arritur të bëhet tërheqës për biznesin vendas. Aktualisht, në Bursën e Tiranës nuk ka asnjë shoqëri të listuar dhe tregtimi i letrave me vlerë të Qeverisë në këtë treg është inekzistent.

Rritja e kërkesës për investime, nga sektori privat dhe shtetëror kërkojnë fillimin e menjëhershëm në procesin e zhvillimit të tregut të kapitaleve. Në këtë kontekst, Qeveria mund të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së zhvillimit të këtij sektori kryesisht nëpërmjet privatizimit të një pakete aksionesh të kompanive strategjike shtetërore në tregun e kapitaleve ose nëpërmjet ofrimit të incentivave të ndryshme fiskale e ligjore për të nxitur biznesin vendas të shfrytëzojë këtë treg dhe listimin në bursë si një mjet financimi.

III. Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale

1. Pavarësia

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si një ent i pavarur raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kooperon me Ministrinë e Financave lidhur me legjislacionin e ri të propozuar sipas direktivave europiane. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare harton rregullore të brendshme dhe rregullore për tregjet që mbikëqyr.

2. Stafi-Burimet Njerëzore

Sektori i burimeve njerëzore është shumë i rëndësishëm sepse arritja e objektivave të vendosura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare varet nga profesionalizmi dhe motivimi i çdo punonjësi.

Objektiva kryesore në fushën e burimeve njerëzore është zhvillimi profesional i punonjësve dhe rritja e motivimit të tyre për të punuar

drejt arritjes së objektivave.

Sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e programit të FSVC (Financial Services Volunteer Corps) ka marrë asistencë të dobishme dhe ndihmë nga ekspertë me eksperiencë të gjatë në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky program fokusohet në këto pika:

- Hartimi i politikave të Burimeve Njerëzore;
- Përkufizimi i drejtimeve të politikave në sektorin e Burimeve Njerëzore;
- Hartimi i programeve për rritjen e kapaciteteve të stafit përfshirë edhe analizat për trainime profesionale;
- Hartimi i përshkrimit të rolit të vendit të punës sipas strukturës organizative të AMF-së;
- Implementimi i një strukture pagash që lejon fleksibilitet bazuar në performancën në punë.

Politikat kryesore të Burimeve Njerëzore fokusohen në inkurajimin dhe promovimin në punë, selektimin e një stafi të përgatitur mirë si edhe zhvillimin profesional nëpërmjet trainimit.

Drejtuesit e AMF-së fokusohen në punësimin e një stafi të kualifikuar që kanë rezultate akademike dhe profesionale të shkëlqyera. Drejtuesit e AMF-së mbështeten tek këta punonjës të kualifikuar për të arritur objektivat kryesore të AMF-së.

Në mënyrë që të mbështetet politika e punësimit, procedura dhe rregulla janë hartuar për stafin dhe i janë prezantuar Bordit të AMF-së për aprovim. Sipas këtyre rregullave, konkurrimi i ndershëm do të jetë mënyra për të tërhequr profesionistë. Gjithashtu, qëllimi do të jetë që të aplikohen metoda të cilat do të lejojnë selektimin e kandidatëve më të mirë, profili i të cilëve do të përputhet me përshkrimet e pozicioneve për të cilët ata do të aplikojnë.

Trainimi i stafit ka konsistuar kryesisht në pjesëmarrje në konferenca dhe work-shops të cilat janë lidhur me sektorë të ndryshëm të sistemit financiar jo-bankar dhe aktiviteti i të cilave është subjekt

i mbikëqyrjes dhe rregullimit nga AMF. Gjithashtu, AMF synon promovimin dhe sponsorizimin deri diku trainimin afat-gjatë të stafit sidomos në fusha që lejojnë arritjen e suksesshme të detyrave dhe objektivave të institucionit.

3. Teknologjia e Informacionit në AMF

Stafi i AMF po punon për një strategji për zhvillimin e IT që do t'i aplikohet institucionit dhe tregut. AMF ka nevojë për një sistem të integruar informacioni i cili kompletion dhe perpunon të gjithë informacionin e duhur si pjesë e aktivitetit institucional ndërsa siguron stabilitet, siguri dhe vazhdimin e proceseve të punës.

Ky sistem i ri informacioni duhet të jetë i aplikueshëm për të gjithë sektorët e mbikëqyrur financiare jo-bankare. Aplikimi do të rregjistrojë të dhëna mbi entet e rregulluara, agjentët e tyre, policat e risigurimit dhe palët e interesuara si aksionerë dhe menaxherë. Këto të dhëna do të hidhen në sistem nga punonjës të AMF-së.

Ky aplikim duhet të mundësojë mbajtjen e një reference (cross) të kryqëzuar me sistemin e imazhit të dokumentit të përdorur nga AMF dhe të lejojë AMF-në të bashkangjisë dokumenta të marra nga entet e mbikëqyrura.

Aplikimi duhet të ketë aftësinë të pranojë këto informacione:

- Të dhëna në faqe Excel të raportura nga shoqëritë e sigurimit. Këto të dhëna duhet të bashkangjiten automatikisht në database.
- Të dhëna të hedhura në sistem me anë te web layer based screens nga shoqëritë e sigurimit. Këto të dhëna duhet të hidhen në sistem sipas rregullave të editimit të database dhe shoqëria e sigurimit duhet të jetë në gjendje të printojë këta dokumenta dhe të raportojë në AMF edhe në mënyrë zyrtare.

IV. Ndryshime Operacionale Strategjike

1. *Kuadri Ligjor*

Struktura rregullative e tregut financiar jo-bankar ndryshoi me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9572, datë 3 Korrik 2006, “ Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Megjithatë, ky ndryshim nuk ishte shoqëruar me infrastrukturen e duhur ligjore për të arritur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj, prandaj rezultuan vështirësi në ndërveprimin me aktorët e tregut. Megjithëse Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një status të pavarur, qëllimi i këtij institucioni rregullues është që të luajë një rol më aktiv drejt iniciativave dhe marrjes së masave rregulluese. Qëllimi i implementimit të infrastrukturës institucionale në sektorin e sigurimeve do të jetë që të përcaktojë qartë rolin e palëve të interesit, AMF-së, Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë, kompanitë e mbikëqyrura dhe organizatave të tjera. Ky proces do të shoqërohet me propozimin për ndryshimet ligjore dhe hartimin e legjislacionit të nevojshëm.

Lidhur me tregun e letrave me vlerë, përveç ndryshimeve të bëra Ligjit Nr. 8080, datë 01.03.1996 “Mbi letrat me vlerë”, një program bashkëpunimi me BERZH (EBRD ka për qëllim hartimin e legjislacionit të nevojshëm dhe kuadrin rregullues mbi emetimin e bonove nga shoqëri aksionere) është në progres.

Tregu i institucioneve të pensioneve private është gjithashtu pjesë e reformës, prandaj, Ligji mbi “Pensionet suplementare dhe Institucionet e Pensioneve Private” dhe aktet nën-ligjore që rrjedhin nga ky ligj janë duke u hartuar sipas reformës së qeverisë në sektorin e pensioneve.

Gjithashtu, një ligj i ri për sigurimet dhe risigurimet po hartohet gjatë kësaj kohe. Ky ligj i rishikuar do të përfshijë kriteret e licencimit për shoqëritë “Group” dhe “ Holding”. Ky ligj do të përcaktojë politika për “Corporate Governance” dhe “Internal Control”.

2. Mbikëqyrja me Bazë Risku

Analiza e veprimtarisë së shoqërisë ka qenë tradicionalisht metoda e mbikëqyrjes për të siguruar se kompania i është përmbajtur legjislacionit në fuqi, si edhe për të siguruar që të dhënat financiare janë përgatitur sipas metodave të duhura të raportimit dhe që reflektojnë situatën financiare aktuale të kompanisë.

Mbikëqyrja me bazë risku është më e avancuar sesa metoda tradicionale sepse procesi i mbikëqyrjes identifikon dhe fokusohet në ato fusha të cilat prezantojnë një risk të lartë për kompaninë dhe mund të rrezikojnë progresin financiar të shoqërisë. Mbikëqyrja me bazë risku fokusohet në identifikimin e risqeve që ndikojnë në veprimtarinë e biznesit si dhe në proceset manaxheriale për të parandaluar dhe zvogëluar këto risqe.

AMF po ndërmerr aktivitete për të përmirësuar proceset e mbikëqyrjes dhe për t'i përshtatur me bazë risku për tregun e sigurimeve në Shqipëri. AMF ka shqyrtuar lëvizjen nga metoda tradicionale drejt metodës së mbikëqyrjes me bazë risku. Zhvillimi dhe stabilizimi i tregjeve financiare, përafrimi me direktivat europiane, rritja makroekonomike do të sjellë një përmirësim të mbikëqyrjes me bazë risku.

Implementimi i Mbikëqyrjes me bazë risku duhet të koordinohet me zhvillimin e IT të "Monitorimit off-site dhe raportimit elektronik" e cila do të financohet nga BERZH (EBRD).

Objektivat kryesore të këtij projekti janë:

- përmirësimi i masave dhe vendimeve të marra nga AMF ,
- përmirësimi i menaxhimit të burimeve të limituara ,
- vendosja e prioriteteve për të përmirësuar procesin e monitorimit të shoqërive të sigurimit dhe zhvillimeve të tregut ,

- përmirësimi i analizës financiare të shoqërive të sigurimit duke marrë në konsideratë riskun e aftësisë paguese dhe ndikimin e tij mbi policmbajtësit për të siguruar menaxhim efikas të politikave të riskut,
- tësigurojëefekteekonomikepozitive nënivelmakroekonomik duke u bazuar në një nivel më të lartë të mbajtjes së riskut.

3. Licencimi

AMF ka propozuar dy Projekte-VKM “Për kriteret dhe procedurat e licencimit të vlerësuesve të dëmëve në sigurime” dhe “Për kriteret dhe kushtet e licencimit të ndërmjetësve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e tyre”. Të dyja këto Projekt-VKM i janë dërguar Ministrisë së Financave për procedura të mëtejshme ligjore.

Për hartimin e këtyre akteve janë marrë në konsideratë direktivat europiane, (Direktiva 2002/92/EC për “ ndërmjetësimin në sigurime”) parimet e IAIS, ligje për ndërmjetësimin në sigurime nga vëndet e rajonit, ligji ynë i sigurimeve si edhe opinione nga operatorët e tregut dhe palët e interesuara.

Në Shqipëri, akoma nuk është implementuar një strukturë bazuar në “Praktikat më të mira ndërkombëtare” që do të siguronte selektimin cilësor të Aktuarëve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po punon për hartimin e një projekt-rregulloreje për “Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për lëshimin dhe revokimin e licencës së Aktuarëve”. Aktuarët duhet të jenë të pajisur me licencë profesionale dhe të rregjistrohen para se të ushtrojnë profesionin e tyre.

Implementimi i kriterëve strikte profesionale për aplikantët që kërkojnë licencë në sektorët e përmendur më sipër si dhe autoriteti që ka AMF për të testuar njohuritë e aplikantëve për të kufizuar kushtet e licencës dhe autoriteti për ta tërhequr përbëjnë një bazë solide për pavarësinë e AMF-së.

4. Mbrojtja e Konsumatorit

Një nga prioritetet e AMF-së është mbrojtja e konsumatorit nëpërmjet përforcimit të ligjit dhe mbikëqyrjes të mjaftueshme në pagesën e dëmeve. AMF po fokusohet në tendencat e tregut lidhur me shërbimin ndaj policmbajtësve gjatë procesit të pagesës së dëmeve.

Kritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit në mënyrë që të mbrohen interesat e konsumatorëve është një prioritet për AMF-në. Për këtë arsye, përveç transparencës lidhur me aktivitetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, një vëmendje e veçantë i është kushtuar informacionit që është në dispozicion të publikut. Në mënyrë që ky prioritet të realizohet, AMF vazhdon të publikojë raporte statistikore informuese lidhur me zhvillimin e tregut financiar jo-bankar.

Mbrojtja e interesave të policmbajtësve përsa u përket interesave ligjorë dhe financiarë është detyra kryesore e AMF-së në fushën e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve. Në këtë kontekst, termi “i siguruar” përfshin policmbajtësit dhe të gjithë personat që kanë të drejtën e një kërkesë-pagese që vjen si rrjedhojë e një kontrate sigurimi si edhe palët e treta që kanë pësuar një dëmtim. AMF duhet të sigurojë që të gjitha transaksionet financiare të shoqërive të sigurimit të jenë konform ligjeve në fuqi dhe parimeve për aktivitetet sigurues.

AMF duhet të shqyrtojë me kujdes ankesat e policmbajtësve megjithëse nxitja e padive civile të ngritura nga policmbajtësit i është lënë gjykatave. Informacion dhe asistencë në raste mosmarrëveshjeje mund të merret nga palët e interesuara.

5. Dëmet

Meqënëse dy të tretat e tregut të sigurimeve është i përbërë nga sigurimi motorrik i detyrueshëm, AMF ka krijuar një grup pune

për hartimin e një udhëzimi mbi përlllogaritjen e kërkesë-pagesave që lindin si rrjedhojë e kontratave të përgjegjësisë së palëve të treta. Grupi i punës përfshinte punonjës të AMF-së, punonjës të shoqërive të sigurimit, përfaqësues të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, dhe avokatë të pavarur që përfaqësojnë palët e dëmtuara. Disa nga çështjet më të rëndësishme që u diskutuan janë:

- Përlllogaritja e të ardhurave personale për pagesën e dëmit në rastet kur policmbajtësi është i papunësuar duke konsideruar pensionin minimal të shtetit si shifër optimale.
- Përdorimi i të ardhurave vjetore aktuale si bazë për llogaritjen e humbjes të së ardhurave personale në raste kur personi që ka vdekur ka qenë i punësuar nga një punëdhënës i huaj ose punëdhënës Shqiptar që jeton jashtë vendit.

AMF i ka propozuar Ministrit të Financave për miratim projekt-udhëzimin “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”. Ky projekt-udhëzim i është dërguar Ministrin të Financave për miratim.

Gjithashtu, AMF ka hartuar udhëzimin “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”, dhe e ka miratuar këtë udhëzim.

AMF ka krijuar një grup pune që po punon mbi hartimin e një ligji të ri sipas direktivave europiane dhe parimeve të IAIS mbi “Kontratat e përgjegjësisë së palëve të treta për sigurimin e detyrueshëm motorrik”.

6. Reforma institucionale e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve

Përsa i përket reformës institucionale të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe sistemit të administrimit të dëmeve, AMF ka nisur

diskutime me përfaqësues të tregut të sigurimeve dhe po shqyrton sisteme të ndryshme të administrimit të dëmeve, të aplikueshme në Shqipëri. Në këtë kontekst, arkitektura e tregut të sigurimeve është në ndryshim përse i përket përgjegjësive dhe ekuilibrave mes Ministrisë së Financave, AMF-së dhe shoqërive të sigurimit që operojnë në treg.

Në mënyrë që të minimizohen problemet e shfaqura në treg dhe të rivendoset kredibiliteti në Byronë Shqiptare të Sigurimeve dhe sistemit të administrimit të dëmeve, AMF në bashkëpunim me Bankën Botërore do të marrë hapat e mëposhtëm:

- Do të shikohet mundësia për rivendosjen e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve si ent i pavarur (jo më i administruar nga Shoqata e Shoqërive të Sigurimeve) në përputhje me kriteret e duhura.
- Primet për Kartonin Jeshil mendohen të përcaktohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, e cila do të përcaktojë tarifat për policat Kufitare.
- Byroja Shqiptare e sigurimit do të administrojë shitjet e policave Kufitare. Të ardhurat nga këto polica do të mbulojnë shpenzimet administrative dhe të gjitha dëmet e lidhura me policat kufitare. Teprica deri në një tavan të rënë dakort, duhet të depozitohet në Fondin e Kompensimit dhe pjesa tjetër duhet të përdoret për të mirëmbajtur databazën, për të përmirësuar cilësinë e infrastrukturës rrugore, dhe për të siguruar fonde për palët e dëmtuara nga aksidentet rrugore.
- Tendera për administrimin e policave kufitare do të organizohen periodikisht.

7. Teknologjia e Informacionit

AMF po punon për hartimin e një strategjie për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, për mbarëvajtjen e punës në

institucion dhe për tregjet që AMF mbikëqyr.

Aktualisht në serverat e institucionit është instaluar “Rregjistri Elektronik Online i shitjeve të policave të sigurimit motorrik të detyrueshëm”. Ky rregjistër identifikon të gjitha policat e shkruara për sigurimet motorrike të palëve të treta. Ky rregjistër mundëson që vula e AMF-së t’i bashkangjitet çdo police të sigurimit motorrik të detyrueshëm.

Përsa i përket tregut të letrave me vlerë, Sistemi GSRM është në testim. Ky sistem është ideuar dhe konceptuar nga AMF më qëllim bërjen transparente ndaj publikut të të dhënave mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara çdo ditë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione qeveritare) nga subjektet e licensuara prej Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

8. Risigurime

Shumica e shoqërive të sigurimit që operojnë në treg nuk kanë kapacitetin e duhur për të lidhur kontrata risigurimi efikase. Si rrjedhojë, këto shoqëri kanë një nivel të lartë të mbajtjes së riskut si dhe kontrata risigurimi me cilësi të ulët. Sipas të dhënave të fundit, vetëm dy shoqëri sigurimi kanë lidhur kontrata risigurimi për katastrofa për të mbuluar rrezikun ndaj tërmetejeve. Aktualisht janë pjekur kushtet për krijimin “Pool” –eve ose për një ri-sigurues lokal që të menaxhojë risqe të veçanta ose për katastrofa.

9. Produkte të reja të sigurimit të detyrueshëm

Promovimi dhe inkurajimi i zhvillimit të tregut financiar jo-bankar do të jetë fokusi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën e ardhshme. Kjo objektivë do të arrihet jo vetëm duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe produkteve në treg, por gjithashtu duke përmirësuar gamën e produkteve të ofruara, në

mënyrë që të plotësohen nevojat e konsumatorëve.

Në kuadrin e integritimit European, ekonomia Shqiptare po zhvillohet me ritme të shpejta dhe po hapet ndaj tregjeve të reja, si rrjedhojë, lindin nevoja të reja të tregut që duhet të adresohen përsa i përket sigurimit të përgjegjësive që lindin nga zhvillimi i aktivitetit tregtar.

Prandaj, AMF po punon për hartimin e një legjislacioni të ri që do të prezantonte në treg produktet e sigurimit të detyrueshëm për aktivitetin tregëtar.

Sigurimi i detyrueshëm i avionëve dhe anijeve

Republika e Shqipërisë ndodhet në zemrën e Ballkanit, rrethuar nga një rivierë shumë e pasur dhe e shfrytëzuar. Rritja ekonomike dhe turizmi do të influencojë aktivitetin e avionëve dhe anijeve në vend dhe jashtë vendit. Këto ndryshime lidhur me rregullat ndërkombëtare në fuqi e bëjnë të nevojshme hartimin e një ligji të ri mbi sigurimin e detyrueshëm të avioneve dhe anijeve.

Gjithashtu, është bërë e nevojshme të kërkohet sigurim i detyrueshëm për çdo mjet që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Aktualisht, nuk ka kuadër ligjor që rregullon sigurimin e anijeve dhe avionëve në Shqipëri. Shoqëritë Shqiptare të avionëve sigurohen me dëshirë të lirë ose sipas legjislacionit në fuqi të vendeve ku ato udhëtojnë.

Sigurimi i Hoteleve

Siguracioni i pronës dhe përgjegjësisë deri tani ka qenë një kriter për marrjen e licencës për ushtrimin e aktivitetit të hotelit, megjithatë, nuk ka produkte të standartizuar përsa u përket kushteve ose nivelit të siguruar.

Ky ligj është i nevojshëm për mbrojtjen e konsumatorit ndaj humbjeve materiale ose dëmtimeve shëndetësore si rrjedhojë e shërbimeve të ofruara nga hotelet.

Sigurimi i përgjegjësisë së pikave të tregëtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve

Aktualisht nuk ka bazë ligjore që rregullon veprimtarinë e pikave të karburantit dhe dëmet që mund të lindin si rrjedhojë e veprimtarisë së tyre.

Hartimi i një ligji të ri për sigurim të detyrueshëm të pikave të karburantit është i nevojshëm për shkak të rreziqeve që lindin nga veprimtaria e tyre. Veprimtaria e biznesit ndikon në sigurinë dhe shëndetin e banorëve që jetojnë në afërsi të tij dhe dëmi që mund t'i shkaktohet biznesit mund të jetë katastrofik.

Sigurimi i përgjegjësive të palëve të treta në industrinë e ndërtimit.

Veprimtaria e ndërtimit përmban rreziqe si për operatorët, ashtu edhe për publikun dhe aktualisht nuk ka bazë ligjore për rregullimin e këtyre rreziqeve. Rrjedhimisht shumica e operatorëve të tregut nuk janë të siguruar.

Në ndërtimet e objekteve ku investitor është shteti sigurimi i vetë ndërtimit ose përgjegjësisë nuk është kërkesë, ndërkohë që sigurimet e përgjegjësisë dhe vetë ndërtimeve kur fondet financohen plotësisht apo pjesërisht nga institucione financiare ndërkombëtare blerja e sigurimeve është pjesë e kontratës standarde me institucionin ndërkombëtar.

Ministria e Transportit, Infrastruktura dhe Telekomunikacioneve po harton një ligj të ri që do të rregullojë industrinë e ndërtimit. Përfshirja në ligj e detyrimit të sigurimit të përgjegjësisë publike do

të duhet të shoqërohet me aktin nën-ligjor përkatës që përcakton blerjen e policës standarte të sigurimit që është aneks i aktit nënligjor.

Sigurim i detyrueshëm për aksidente personale të punonjësve gjatë ushtrimit të profesionit.

Ka profesione të ushtruara me shkallë të lartë rrezikshmërie si psh në fushën e ndërtimit. Dëmtime të tilla shoqërohen me pasoja financiare për vetë të dëmtuarit dhe familjet e tyre. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, dëmtime të tilla mbulohen nga skemat e detyrueshme e sigurimeve shoqërorë e shëndetësore, por sigurimi sipas këtyre skemave nuk mund të përballojë tërësisht kostot e kurimit brënda dhe jashtë vendit dhe mbijetesën e familjarëve.

Rekomandohet që të kërkohet sigurimi i detyrueshëm i punonjësve të këtyre profesioneve për aksidentet personale në punë.

Sigurimi i katastrofave natyrore

Shumica e pronave të siguruara ndaj katastrofave natyrore në Shqipëri janë të lidhura me dhënien e kredisë nga bankat e nivelit të dytë. Pajisja me këtë lloj siguracioni përbën një kriter për aprovimin e kredisë nga bankat. Aktualisht, nuk ka bazë ligjore që e bën të detyrueshëm këtë lloj sigurimi. Shqipëria është vend i ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore si tërmeti e përmbytja. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të zhvillohen programe kombëtare të mbrojtjes nga katastrofat natyrore, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare. Kjo mbetet një sfidë e madhe për vendin dhe kryesisht për sektorin e sigurimeve.

10. Perspektiva e zhvillimit të vrullshëm të sektorit financiar jo - bankar

Qëndrueshmëria makroekonomike e Shqipërisë, tendencat e fundit të rritjes së sektorit bankar, progresi në regjimin rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit financiar jo-bankar, së bashku me

potencialet e larta që ofron vendi, pritet të shoqërohen me një zhvillim të vrullshëm të tregjeve financiare jo – bankare.

Faktorët e mësipërm kanë ndikim pozitiv në rritjen e interesit të investitorëve të huaj prestigjiozë kundrejt tregjeve financiare jo – bankare në Shqipëri. Interesi i investitorëve seriozë, tashmë i konkretizuar në sektorin e sigurimeve me investimet e kohëve të fundit, po vijon të rritet edhe për sektorët e letrave me vlerë dhe pensioneve private.

Implementimi i përvojave dhe praktikave më të mira ka nisur të japë frutet e veta me hedhjen në treg të produkteve të reja të sigurimeve, kryesisht në fushën e jetës dhe shëndetit. Ndikime pozitive të mëtejshme priten në elementë të tjerë si qeverisja e shoqërisë dhe cilësia e shërbimeve.

AMF do të vijojë të gjejë së bashku me tregjet, mundësi të reja të zhvillimit të shëndoshë të tregjeve. Planifikimi i drejtë, i kombinuar me një staf të kualifikuar për të përballuar tërësinë e detyrave dhe me bashkëpunimin në rritje me tregjet, mbeten mjete të fuqishme në funksion të realizimit të prioriteteve dhe objektivave të AMF-së. Rritja e efektivitetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo – bankare do të shoqërohet me fushata edukuese dhe nxitëse për publikun, që do të synojnë rritjen e ndërgjegjësimit, interesit dhe për rrjedhojë të kërkesës për produkte financiare.

